

LIGJ
Nr. 60/2018

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDRYSHUESE ME SHKËMBIM NOTASH QË PËRDMITËSON MARRËVESHJEN NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE ZYRËS SË POLICISË EVROPIANE (EUROPOL) PËR BASHKËPUNIMIN STRATEGJIK DHE OPERACIONAL, RATIFIKUAR ME LIGJIN NR. 28/2014

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndryshuese me shkëmbim notash që përditëson marrëveshjen ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Zyrës së Policisë Evropiane (Europol) për bashkëpunimin strategjik dhe operacional, ratifikuar me ligjin nr. 28/2014, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 20.9.2018

Shpallur me dekreten nr. 10894, datë 10.10.2018 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta



DREJTORI EKZEKUTIV

Lënda: Propozim mbi përditësimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Europolit

I nderuar zoti ministër/shkëlqesi,

Siç mund të jeni informuar, kuadri ligjor i Europolit ka ndryshuar si rezultat i hyrjes në fuqi të Rregullores së re në maj të këtij viti. Mandati i Europolit mbulon veprat penale të cilat lidhen me krimet e rënda që prekin dy ose më shumë vende të Bashkimit Evropian, terrorizmin dhe format e tjera të krimit që prekin një interes të përbashkët të mbuluar nga një politikë e Bashkimit Evropian, siç renditet në shtojcën 1 të Rregullores së Europolit, një kopje të së cilës do ta gjeni në materialin bashkëlidhur.

Në këtë kontekst, me anë të kësaj letre, propozoj përditësimin e qëllimit të Marrëveshjes për Bashkëpunimin Strategjik dhe Operacional ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Europolit, të nënshkruar në Hagë më 9.12.2013, me të gjitha fushat e krimit që janë renditur në shtojcën të Rregullores së Europolit, me anë të shkëmbimit të dokumenteve siç theksohet në nenin 25 të Marrëveshjes. Nëse ky propozim do të ketë miratimin tuaj, kam nderin të sugjeroj që kjo letër së bashku me pranimin në formë të shkruar, të përbëjë një Marrëveshje ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Europolit për përditësimin e qëllimit të marrëveshjes sonë.

Ky përditësim, në rast se ju pranoni, do të zbatohet në datën kur Europol do të marrë miratimin tuaj me shkrim.

Europol i përfiton nga kjo mundësi për të përsëritur sigurinë e konsideratës më të lartë.

Me respekt,
Rob Wainwright
Drejtor Ekzekutiv

Lënda: Përditësim mbi qëllimin e Marrëveshjes sonë të Bashkëpunimit

I nderuar zoti drejtor ekzekutiv,

Kam nderin të pranoj marrjen e letrës suaj, të datës _____, në të cilën propozoni të përditësoni fushën e bashkëpunimit tonë në të gjitha fushat e krimeve të renditura sipas shtojcës I të rregullores së Europolit.

Kam nderin të konfirmoj që Republika e Shqipërisë pranon propozimin tuaj dhe, gjithashtu, bie dakord se letra juaj dhe kjo përgjigje përbëjnë një marrëveshje ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Europolit në lidhje me përditësimin e fushës së Marrëveshjes sonë, në përputhje me procedurën e parashikuar në nenin 25 të saj.

Sipas propozimit tuaj, unë e konsideroj përditësimin e qëllimit të Marrëveshjes sonë të Bashkëpunimit që të ketë hyrë në fuqi me këtë letër.

Jam në pritje të vazhdimit, si dhe zgjerimit të bashkëpunimit tonë ekzistues.

Me respekt,